

Grupa Parlamentare
16/12/2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

Lënda: Propozohet për shqyrtim dhe miratim një projektligj.

Drejtuar: Znj. Lindita NIKOLLA
Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë

Këtu

Znj. Kryetare e Kuvendit,

Në mbështetje të nenit 81, pika 1 të Kushtetutës dhe nenit 68, pika 1 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, bashkëlidhur gjeni për shqyrtim dhe miratim projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 55/2015. "Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar", shoqëruar me relacionin përkatës, të propozuar nga deputetja Jorida Tabaku.

Ju lutem, marrjen e masave për nisjen e procedurave parlamentare për shqyrtimin dhe miratimin e këtij projektligji në Kuvendin e Shqipërisë, në përputhje me nenet 68 e vijues të Rregullores.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

DEPUTETE

Jorida TABAKU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. ____/2022

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 55/2015, “PËR INVESTIMET STRATEGJIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e deputetes Jorida Tabaku,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 55/2015 “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

Neni 1

Në nenin 36, fjalët “data 31 dhjetor 2023” zëvendësohen me fjalët “data 1 janar 2023”.

Neni 2

Dispozitë kalimtare

Të gjitha kërkesat e bëra pas datës 1 janar 2023, do të refuzohen nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARJA

Lindita NIKOLLA

Miratuar, më ____ . ____ .2022

RELACION

PËR PROJEKTLIGJIN

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 55/2015 “PËR INVESTIMET STRATEGJIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Në datën 28.05.2015, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 55/2015 “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”. Qëllimi i këtij ligji ishte nxitja dhe tërheqja e investimeve strategjike, vendase dhe të huaja, në sektorët e ekonomisë, të identifikuar prej këtij ligji si sektorë strategjikë, nëpërmjet vendosjes së procedurave të posacme administrative favorizuese, lehtësuese apo përshpejtësuese të mbështetjes e të shërbimeve ndaj investitorëve (*shih nenin 1*).

Me investime strategjike, ligji ka përcaktuar ato investime që kryhen në një nga sektorët ekonomikë strategjikë, sipas përcaktimeve të vetë ligji (*shih neni 3, pika 6*). Si të tillë, janë konsideruar sektorët (i) energjetik dhe minerar; (ii) transport, infrastrukturë e komunikimeve elektronike dhe mbetjet urbane; (iii) turizëm (struktura turistike); (iv) bujqësi (ferma e madhe bujqësore) dhe peshkim; (v) zona e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik; dhe (vi) zona me përparësi zhvillimi (*shih nenin 8*). Në ligj janë detajuar edhe vlera e investimit dhe numri i punonjësve për secilin sektor.

Për zbatimin e këtij ligji, është parashikuar ngritja e Komitetit të Investimeve Strategjike, një komitet ndërministror, i kryesuar nga Kryeministri dhe në përbërje të tij janë zv.kryeministri, ministri i Financave dhe Ekonomisë, ministri i Turizmit dhe Mjedisit, ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, ministri i Zhvillimit Urban, ministri i Bujqësisë dhe Avokati i Përgjithshëm i Shtetit (*shih nenin 9*). Kompetenca kryesore e këtij Komiteti është miratimi i statusit “Investim/investitor strategjik”, e cila nënkupton dhënien e një sërë masash mbështetëse për personin juridik privat, vendas apo i huaj, përfshirë edhe vënien në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore apo shpronësimet për interes publik (*shih nenet 26–31*).

Ligji parashikonte se afati i fundit për paraqitjen e kërkesave nga subjektet investuese të interesuara për përfshirjen në procedurat për përfitimin e statusit “Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar/e vecantë”, është data 31 dhjetor 2018 (*shih nenin 36*). Megjithatë, ligji është ndryshuar katër herë, ndryshimi i fundit i bërë në datën 20.12.2021, me ligjin nr. 130/2021 “Për një ndryshim në ligjin nr. 55/2015 “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, ku afati për paraqitjen e kërkesave është shtyrë deri në datën 31 dhjetor 2023.

Në relacionin e këtij projektligji thuhet “Shtyrja e këtij afati është miratuar edhe më parë pasi nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është në proces hartimi i një projektligji “Për investimet”, i cili ka lindur si domosdoshmëri, pasi legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë i jepte një mbrojtje

shtesë investimeve të huaja, por jo atyre vendase, ndërkohë që një korpus i ri ligjor më vete ishte krijuar për investimet strategjike.” (shih fq. 1 të relacionit)

Megjithëse qëllimi i këtij ligji, pra mbështetja dhe nxitja e investimeve, vendase dhe të huaja, në sektorët strategjikë për zhvillimin e ekonomisë së vendit, ishte pozitiv, në praktikë ka rezultuar se ai është përdorur kryesisht si një mekanizëm për t'u dhënë favore dhe përfitime individëve me lidhje të forta personale apo familjare pranë qeverisë dhe drejtuesve të Partisë Socialiste. Në cdo rast, mbi këto projekte ka pasur hije dyshimi për korrupsion, favorizim, klientelizëm dhe arbitraritet. Ndërkohë, që shifra në numër projektesh apo vlerë investimesh, të përfituar nga investitorë të huaj mbeten modeste.

Në media janë publikuar edhe së fundmi disa raste, të cilat ngrejnë dyshime të forta për paligjshmëri, korrupsion dhe klientelizëm, të tilla si: (i) rasti i Portit të Durrësit; (ii) rasti i anëtarit të Këshillit Bashkiak Tiranë (PS), z. Gazmend Paja, i cili ka përfituar 133 mijë m² në Dhërmi; dhe (iii) rasti i bashkëshortit të ministres për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe deputetes së PS-së, znj. Olta Xhacker, ish-deputeti socialist z. Artan Gaci, i cili ka përfituar të drejtën e përdorimit të brigjeve të detit dhe të zonës përkatëse të plazhit përballë kompleksit që po ndërtohet në fshatin Gjilekë të bashkisë Himarë.

Këto raste, por edhe të tjera të miratuara nga Komiteti i Investimeve Strategjike, kanë nxitur aludime të ndryshme mbi qëllimet reale të këtij ligji, i cili duket të jetë shndërruar në një mekanizëm të qeverisë për të shpërblyer njerëzit e saj, ministria, deputetë, kryebashkiakë dhe biznese që kryesisht mbështesin qeverinë apo Partinë Socialiste.

Me qëllim adresimin e këtyre problematikave të krijuara, deputetja Jorida Tabaku propozon që afati për paraqitja e kërkesave nga subjektet e interesuara të ndryshohet duke vendosur si afat datën 1 janar 2023. Cdo projekt që do të paraqitet pas kësaj date do të refuzohet nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve. Ky projektligj shënon fundin e një praktike që ka rezultuar mjaft problematike në realitet, duke ngërthyer një sërë akuzash për paligjshmëri, arbitraritet, klientelizëm dhe korrupsion.

II. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ligji nr. 55/2015 “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, me gjithë qëllimin e tij të mirë të shprehur në letër për thithjen dhe zhvillimin e investimeve të huaja dhe vendase, në praktikë jo vetëm nuk ka rezultuar i suksesshëm, por mjaft problematik në disa drejtime. Kompani dhe personazhe të dyshimta, në bashkëpunim me qeverinë, kanë përdorur mekanizmat që ofron ky ligj, për të përfituar apo marrë nën administrim pasuri të rëndësishme, pa asnjë lloj gare, transparence apo konkurrence.

Kjo sigurisht në dëm të interesit publik, por edhe të vetë tregut të lirë, pasi investitorë të tjerë vendas apo të huaj detyrohen t'i nënshtrohen procedurave konkurruese, të paguajnë të gjitha detyrimet tatimore, dhe madje jo vetëm të mos mbështeten nga qeveria, por shpeshherë t'u krijon pengesa që pamundësojnë realizimin e investimeve të tyre. Rastet e publikuara në media dhe të cituara më lart, vecanërisht rasti i Portit të Durrësit është një shembull kuptimplotë se si një pasuri shumë e rëndësishme shtetërore i falet një kompanie private, pronësia e të cilës mbetet e dyshimtë për shkak të regjistrimit në parajsë fiskale,

duke e përjashtuar nga taksa për ndikimin në infrastrukturë dhe kontributin social, pa pasur asnjë lloj garancie nëse projekti do të realizohet, nëse shteti shqiptar do të nxjerrë ndonjë përfitim nga ky projekt, dhe pa asnjë lloj sigurie se ky projekt nuk do të shndërrohet në një lavatrice të pastrimit të parave.

Në vlerësimin tonë, ligji aktual paraqet problematika në raport me rregullimet e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, nenet 71 dhe 74 të së cilës sanksionojnë parimet e konkurrencës së lirë dhe mosdiskriminimit në të gjitha llojet e kontratave publike. Pikërisht, në momentin që ndodhet Shqipëria, pas hapjes së negociatave, aplikimi i një ligji që krijon problematika në raport me Marrëveshjen kuadër të Shqipërisë me vendet e Komunitetit Evropian, do të ishte mesazhi më i gabuar që iu dërgohet shteteve anëtare.

Prandaj, me qëllim dhënien fund njëherë e mirë të këtyre praktikave, projektligji i propozuar parashikon kufizimin e afatit të zbatueshmërisë së këtij ligji deri në datën 1 janar 2023, sa i përket paraqitjes së kërkesave. Duke qenë të vetdijshëm që shqyrtimi i projektligjit mund të shkojë edhe përtej këtij afati, dispozita kalimtare sanksionon se të gjitha kërkesat që do të paraqiten pas këtij afati, do të refuzohen apriori nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA).

Miratimi i këtij projektligji do t'i mbyllte rrugë cdo përpjekje që kompani apo biznese të lidhura me nivelet e larta drejtuese të shtetit apo qeverisë, si dhe funksionarë të lartë që fshihen pas këtyre bizneseve të përfitojnë pasuri të cmuara shtetërore, duke u përjashtuar njëkohësisht nga detyrimet tatimore. Nga ana tjetër, dhënia fund e këtyre praktikave që shihen me dyshim edhe nga institucionet e Bashkimit Evropian, sic është komunikuar nga qëndrimi i Delegacionit të BE-së në Tiranë së fundmi, lidhur me projektin e Portit të Durrësit, është një sinjal pozitiv në kuadër të procesit të negociatave.

III. VLERESIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është propozim i një deputetje të Kuvendit të Shqipërisë, në përputhje me nenin 81, pika 1 të Kushtetutës së Shqipërisë, dhe nenin 68 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë. Projektligji po ashtu synon që legjislacioni shqiptar të jetë në harmoni me rregullimet e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, vecanërisht nenet 71 dhe 74 të saj.

IV. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përbëhet nga 3 dispozita.

Neni 1 përmban ndryshimin e afatit për paraqitjen e kërkesave për përfitimin e statusit të investitorit strategjik, me një afat maksimal deri në datën 1 janar 2023.

Neni 2 përbën një dispozitë kalimtare, e cila përcakton se të gjitha kërkesat e paraqitura pas datës 1 janar 2023, do të refuzohen nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve.


Neni 3 parashikon hyrjen në fuqi të ligjit 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, në përputhje neni 83, pika 4 të Kushtetutës.

V. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji nuk parashikon efekte financiare për Buxhetin e Shtetit.

DEPUTETE

Jorida TABAKU

A handwritten signature in blue ink, consisting of a large, stylized 'J' followed by a series of loops and a long horizontal stroke extending to the right.

RELACION

PËR PROJEKTLIGJIN

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 55/2015 “PËR INVESTIMET STRATEGJIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Në datën 28.05.2015, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 55/2015 “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”. Qëllimi i këtij ligji ishte nxitja dhe tërheqja e investimeve strategjike, vendase dhe të huaja, në sektorët e ekonomisë, të identifikuar prej këtij ligji si sektorë strategjikë, nëpërmjet vendosjes së procedurave të posacme administrative favorizuese, lehtësuese apo përsheptësuese të mbështetjes e të shërbimeve ndaj investitorëve (*shih nenin 1*).

Me investime strategjike, ligji ka përcaktuar ato investime që kryhen në një nga sektorët ekonomikë strategjikë, sipas përcaktimeve të vetë ligji (*shih neni 3, pika 6*). Si të tillë, janë konsideruar sektorët (i) energjetik dhe minerar; (ii) transport, infrastrukturë e komunikimeve elektronike dhe mbetjet urbane; (iii) turizëm (struktura turistike); (iv) bujqësi (ferma e madhe bujqësore) dhe peshkim; (v) zona e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik; dhe (vi) zona me përparësi zhvillimi (*shih nenin 8*). Në ligj janë detajuar edhe vlera e investimit dhe numri i punonjësve për secilin sektor.

Për zbatimin e këtij ligji, është parashikuar ngritja e Komitetit të Investimeve Strategjike, një komitet ndërmintor, i kryesuar nga Kryeministri dhe në përbërje të tij janë zv.kryeministri, ministri i Financave dhe Ekonomisë, ministri i Turizmit dhe Mjedisit, ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, ministri i Zhvillimit Urban, ministri i Bujqësisë dhe Avokati i Përgjithshëm i Shtetit (*shih nenin 9*). Kompetenca kryesore e këtij Komiteti është miratimi i statusit “Investim/investitor strategjik”, e cila nënkupton dhënien e një sërë masash mbështetëse për personin juridik privat, vendas apo i huaj, përfshirë edhe vënien në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore apo shpronësimet për interes publik (*shih nenet 26–31*).

Ligji parashikonte se afati i fundit për paraqitjen e kërkesave nga subjektet investuese të interesuara për përfshirjen në procedurat për përfitimin e statusit “Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar/e vecantë”, është data 31 dhjetor 2018 (*shih nenin 36*). Megjithatë, ligji është ndryshuar katër herë, ndryshimi i fundit i bërë në datën 20.12.2021, me ligjin nr. 130/2021 “Për një ndryshim në ligjin nr. 55/2015 “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, ku afati për paraqitjen e kërkesave është shtyrë deri në datën 31 dhjetor 2023.

Në relacionin e këtij projektligji thuhet “Shtyrja e këtij afati është miratuar edhe më parë pasi nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është në proces hartimi i një projektligji “Për investimet”, i cili ka lindur si domosdoshmëri, pasi legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë i jepte një mbrojtje

shtesë investimeve të huaja, por jo atyre vendase, ndërkohë që një korpus i ri ligjor më vete ishte krijuar për investimet strategjike.” (shih fq. 1 të relacionit)

Megjithëse qëllimi i këtij ligji, pra mbështetja dhe nxitja e investimeve, vendase dhe të huaja, në sektorët strategjikë për zhvillimin e ekonomisë së vendit, ishte pozitiv, në praktikë ka rezultuar se ai është përdorur kryesisht si një mekanizëm për t’u dhënë favore dhe përfitime individëve me lidhje të forta personale apo familjare pranë qeverisë dhe drejtuesve të Partisë Socialiste. Në cdo rast, mbi këto projekte ka pasur hije dyshimi për korrupsion, favorizim, klientelizëm dhe arbitraritet. Ndërkohë, që shifra në numër projektesh apo vlerë investimesh, të përfituar nga investitorë të huaj mbeten modeste.

Në media janë publikuar edhe së fundmi disa raste, të cilat ngrejnë dyshime të forta për paligjshmëri, korrupsion dhe klientelizëm, të tilla si: (i) rasti i Portit të Durrësit; (ii) rasti i anëtarit të Këshillit Bashkiak Tiranë (PS), z. Gazmend Paja, i cili ka përfituar 133 mijë m² në Dhërmi.

Këto raste, por edhe të tjera të miratuara nga Komiteti i Investimeve Strategjike, kanë nxitur aludime të ndryshme mbi qëllimet reale të këtij ligji, i cili duket të jetë shndërruar në një mekanizëm të qeverisë për të shpërblyer njerëzit e saj, ministria, deputetë, kryebashkiakë dhe biznese që kryesisht mbështesin qeverinë apo Partinë Socialiste.

Me qëllim adresimin e këtyre problematikave të krijuara, deputetja Jorida Tabaku propozon që afati për paraqitja e kërkesave nga subjektet e interesuara të ndryshohet duke vendosur si afat datën 1 janar 2023. Cdo projekt që do të paraqitet pas kësaj date do të refuzohet nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve. Ky projektligj shënon fundin e një praktike që ka rezultuar mjaft problematike në realitet, duke ngërthyer një sërë akuzash për paligjshmëri, arbitraritet, klientelizëm dhe korrupsion.

II. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ligji nr. 55/2015 “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, me gjithë qëllimin e tij të mirë të shprehur në letër për thithjen dhe zhvillimin e investimeve të huaja dhe vendase, në praktikë jo vetëm nuk ka rezultuar i suksesshëm, por mjaft problematik në disa drejtime. Kompani dhe personazhe të dyshimta, në bashkëpunim me qeverinë, kanë përdorur mekanizmat që ofron ky ligj, për të përfituar apo marrë nën administrim pasuri të rëndësishme, pa asnjë lloj gare, transparence apo konkurrence.

Kjo sigurisht në dëm të interesit publik, por edhe të vetë tregut të lirë, pasi investitorë të tjerë vendas apo të huaj detyrohen t’i nënshtrohen procedurave konkurruese, të paguajnë të gjitha detyrimet tatimore, dhe madje jo vetëm të mos mbështeten nga qeveria, por shpeshherë t’u krijon pengesa që pamundësojnë realizimin e investimeve të tyre. Rastet e publikuara në media dhe të cituara më lart, vecanërisht rasti i Porti të Durrësit është një shembull kuptimplotë se si një pasuri shumë e rëndësishme shtetërore i falet një kompanie private, pronësia e të cilës mbetet e dyshimtë për shkak të regjistrimit në parajsë fiskale, duke e përjashtuar nga taksa për ndikimin në infrastrukturë dhe kontributin social, pa pasur asnjë lloj garancie nëse projekti do të realizohet, nëse shteti shqiptar do të nxjerrë ndonjë përfitim nga ky projekt, dhe pa asnjë lloj sigurie se ky projekt nuk do të shndërrohet në një lavatrice të pastrimit të parave.

Në vlerësimin tonë, ligji aktual paraqet problematika në raport me rregullimet e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, nenet 71 dhe 74 të së cilës sanksionojnë parimet e konkurrencës së lirë dhe mosdiskriminimit në të gjitha llojet e kontratave publike. Pikërisht, në momentin që ndodhet Shqipëria, pas hapjes së negociatave, aplikimi i një ligji që krijon problematika në raport me Marrëveshjen kuadër të Shqipërisë me vendet e Komunitetit Evropian, do të ishte mesazhi më i gabuar që iu dërgohet shteteve anëtare.

Prandaj, me qëllim dhënien fund njëherë e mirë të këtyre praktikave, projektligji i propozuar parashikon kufizimin e afatit të zbatueshmërisë së këtij ligji deri në datën 1 janar 2023, sa i përket paraqitjes së kërkesave. Duke qenë të vetdijshëm që shqyrtimi i projektligjit mund të shkojë edhe përtej këtij afati, dispozita kalimtare sanksionon se të gjitha kërkesat që do të paraqiten pas këtij afati, do të refuzohen apriori nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA).

Miratimi i këtij projektligji do t'i mbyllte rrugë cdo përpjekje që kompani apo biznese të lidhura me nivelet e larta drejtuese të shtetit apo qeverisë, si dhe funksionarë të lartë që fshihen pas këtyre bizneseve të përfitojnë pasuri të cmuara shtetërore, duke u përjashtuar njëkohësisht nga detyrimet tatimore. Nga ana tjetër, dhënia fund e këtyre praktikave që shihen me dyshim edhe nga institucionet e Bashkimit Evropian, sic është komunikuar nga qëndrimi i Delegacionit të BE-së në Tiranë së fundmi, lidhur me projektin e Portit të Durrësit, është një sinjal pozitiv në kuadër të procesit të negociatave.

III. VLERESIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është propozim i një deputetje të Kuvendit të Shqipërisë, në përputhje me nenin 81, pika 1 të Kushtetutës së Shqipërisë, dhe nenin 68 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë. Projektligji po ashtu synon që legjislacioni shqiptar të jetë në harmoni me rregullimet e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, vecanërisht nenet 71 dhe 74 të saj.

IV. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përbëhet nga 3 dispozita.

Neni 1 përmban ndryshimin e afatit për paraqitjen e kërkesave për përfitimin e statusit të investitorit strategjik, me një afat maksimal deri në datën 1 janar 2023.

Neni 2 përbën një dispozitë kalimtare, e cila përcakton se të gjitha kërkesat e paraqitura pas datës 1 janar 2023, do të refuzohen nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve.


Neni 3 parashikon hyrjen në fuqi të ligjit 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, në përputhje neni 83, pika 4 të Kushtetutës.

V. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji nuk parashikon efekte financiare për Buxhetin e Shtetit.

DEPUTETE

Jorida TABAKU

A handwritten signature in blue ink, consisting of stylized, cursive letters that appear to read 'J. Tabaku'.